



BULETIN MUJOR

MAJ 2025



PËRMBAJTJA

- Western Balkan Cyber Camp 2025 – 60 të rinj nga 6 vende të Ballkanit përgatiten në Shqipëri për sfidat e sigurisë kibernetike
- AKSK vijon bashkëpunimin me universitetet: Trajnim me platformën SimSpace për studentët në FSHN
- Ekspertët e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit trajnohen me platformën SimSpace
- Higjiena Kibernetike në fokus/ AKSK trajnim ndërgjegjësues në Durrës
- Studentët e FTI pjesë e një trajnimi teknik “Capture The Flag” (CTF)

Western Balkan Cyber Camp 2025 – 60 të rinj nga 6 vende të Ballkanit përgatiten në Shqipëri për sfidat e sigurisë kibernetike



AKSK përmbylli me sukses Western Balkan Cyber Camp 2025, një kamp treditor që mbledhi 60 të rinj nga gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, me synimin për të zhvilluar aftësitë e tyre teknike dhe strategjike në fushën e sigurisë kibernetike. Ky kamp shërbeu si një platformë unike për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, duke promovuar bashkëpunimin rajonal dhe krijimin e lidhjeve të qëndrueshme mes të rinjve me interesa të përbashkëta në sigurinë digjitale.

Edicioni i dytë i këtij kampi konfirmoi përkushtimin e AKSK për të mbështetur talentet e reja dhe për të forcuar sigurinë rajonale.

AKSK vijon bashkëpunimin me universitetet: Trajnim me platformën SimSpace për studentët në FSHN

AKSK zhvilloi me studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, një trajnim praktik duke përdorur platformën SimSpace. Ata u përfshinë në simulime reale të sulmeve kibernetike dhe patën mundësinë të ushtrorin njohuritë e tyre në kushte të kontrolluara, nën udhëzimin e ekspertëve tanë.

Ky trajnim është pjesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm të AKSK me universitetet në vend, me synimin për të forcuar aftësitë praktike të studentëve dhe për të përgatitur një brez të gatshëm të mbrojtë të ardhmen digjitale të Shqipërisë.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



[@aksk.gov.al](https://www.instagram.com/aksk.gov.al)



+355 422 21 039



Ekspertët e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit trajnohen me platformën SimSpace

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi një trajnim teknik intensiv duke përdorur platformën SimSpace, këtë herë për ekspertët e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit.

Pjesëmarrësit u përfshinë në simulime të avancuara të sulmeve kibernetike, duke testuar dhe përmirësuar kapacitetet e tyre për të reaguar në skenarë realë.

Ky angazhim është pjesë e vizionit të AKSK për të rritur qëndrueshmërinë kibernetike të vendit, duke ndërtuar kapacitete të qëndrueshme dhe një komunitet ekspertësh të përgatitur për sfidat komplekse që paraqet mbrojtja e infrastrukturave kritike në epokën digjitale.

Higjiena Kibernetike në fokus/ AKSK trajnim ndërgjegjësues në Durrës

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) vijon angazhimin në forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike. Në kuadër të këtij qëllimi, u organizua trajnimi "Higjiena Kibernetike", në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Trajnimi mbledhi rreth 700 pjesëmarrës online dhe 25 pjesëmarrës fizikisht, përfaqësues nga sektori publik, sektori privat, shoqëria civile dhe Universitetet duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe diskutimin mbi kërcënimet dhe zgjidhjet aktuale në fushën e sigorisë kibernetike.

Pjesëmarrja e gjerë thekson rëndësinë e aktiviteteve të kësaj natyre për garantimin e një ekosistemi digjital të sigurtë.



Studentët e FTI pjesë e një trajnimi teknik "Capture The Flag" (CTF)

AKSK në bashkëpunim me Shoqatën ACTI dhe me pjesëmarrjen e studentëve të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI), organizoi një trajnim teknik me formatin "Capture The Flag" (CTF), duke i vënë në qendër të vëmendjes të rinjtë që po formohen në fushën e sigorisë kibernetike.

Përmes platformës SimSpace, studentët u përfshinë në një trajnim praktik të avancuar, i cili simuloi skenarë realistë të sulmeve kibernetike. Ky format sfidues i lejoi ata të testojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në identifikimin dhe menaxhimin e incidenteve në kohë reale, duke u përballur me probleme komplekse të sigurisë digjitale.